


BIBLIOTEKA

85H-1

Ø 32



# YLLI I MĒNGJESIT

JAIK S. DEDA

8SH - 1  
S. 32

FAIK S. DEDA

S

# YLLI I MËNGJEZIT

— VARGJE —

38650

LIBRERIA  
G. FRANCISCA

12046

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## ATDHEU.

Do mplaken monumentet në revan të kohës,  
po vetëm ti, Atdhe, s'do thinjesh kurre!  
Ti monument mes shqotës e ëhe llohës,  
që zemrat njerëzore i rinon,  
gjak të çfardollojtë merr nga 'to;  
por veç gjak të pastër ti buron...

## YLLI I MËNGJEZIT

1.

Sa i bukur dhe sa i afërt  
më ngjan këtë natë,  
ai yll — jo si gjith' yjet,  
ai yll  
aq i ndritur, sa dhe i largët...

...Po këmbejmë së bashku mendimet,  
nga një stan lebërish, ku verojnë dhëntë.  
E kuuptojmë njëri tjetrin fare mirë,  
dhe unë,  
i shtrirë në një cep të shtrungës,  
mbështjellë me një gunë të dhirë,  
e vështroj  
me atë mall labi, që nuk ka të sosur...

2.

Nuk lakmoj  
të kem ndër grushte rubin yjesh të ndritur,  
për të stolisur  
yllin e zemrës sime,

ndonëse  
dua edhe unë që e dashura ime  
m'e bukura të jet' ndër gjith' vajzat.

3.

Sonte,  
në këtë natë, kur Yll' i Mëngjesit  
u ul për të pirë një kupë me dhallë  
dhe... po i pëlqen të pushojë e të çmallohet  
me stanicin tim në rrëz' të Këndrevicës,  
... unë rri dhe mendoj:

Dua,  
gjer në çastin e fundit të jetës,  
pavdekësinë e Atdheut tim  
në fytyrën e tij  
të kundroj!

## NE UDHËN E VJETËVE

1

Malet shqipëtare  
me festë të bardha i mbulojnë kokat,  
mendime të pastra derdhin me furi  
ujvareve të thinjura nga lartësitë;  
reve u vrasin sytë me bardhësi,  
vetëtimave  
me gjokset e rreshkura u bëjnë pritë.

2

Në këta male, shkëmb jan' shqipëtarët,  
që, duke mbartur stiva dertesh,  
u kacafytën me motet e trubullta,  
me armiq të egër,  
në këta male.

...U përkulen dhe vetë shekujt,  
po dot s'i përulen  
qeleshet e bardha tek opingat me gjalmë.

Shqipëtarët e prisnin Ditën e Madhe  
 të rinj nga zemrat e nga hallet thinjur,  
 me nofullat shtërnguar  
 dhe armët gati,  
 e trurin të nginjur  
 nga gjerdane ëndrash aq të bukura.

E prisnin atë ditë shqipëtarët,  
 siç pret bujku shiun pas thatësirës së madhe,  
 kur në thes s'i ka mbetur veç një dorë miell.  
 E prisnin,  
 zhuritur nga vapa mes ugarit e zallishthes,  
 me buzën plasur për një gllënkë liri.

Kur dielli i Tetorit  
 rezet e tij ja shpërndau globit  
 ahere...  
 shpresat u ringjallën,  
 Vegjelia lëvizi  
 përqafoi idetë e Leninit,  
 i qëndroi grusht fashizmit.  
 Dhe Kapiteni i shqipëtarëve dha kushtrimin,  
 gjoks-shqyerit mësuan këngën e Stalinit,  
 opingat dhe maliherët nisën marshimin,  
 bijtë e Nëndorit  
 i ngritën historisë Hymnin!

## D E S H M O R È V E

1

Ç'ju kënduan nënët nëpër ligjëratë,  
Po dertet e tyre, kush i shkruan vallë?  
Aq të thellën dhëmbje, kur vinte mandata,  
Cila nën' s'e shprazi ndër vargje të rrallë?

2

Morët udh' të largët dhe s'u kthyet më,  
Po lavdia juaj u ngrit përmbi male;  
Si stoli për brezat na e lanë atë  
Nënët tonë trime, nënët shqipëtare!

3

Bën apel Atdheu. Po, pse s'fisni vallë?  
Apo mos u dhëmbin plagët aq të rënda?  
...Rrudh ballin Enveri dhe qafon me mallë  
Nënat shamizeza, zëmërbardhat nëna!

4

## MËNGJEZ I KUQ

1

Me gjak seç e ndezi kjo drit'mëngjezore  
Kurorën me kodra, rrotull Progonatit.  
... Nis cula avazin, tej në një zallore  
Ja, u hapën dyert e ra briri i fshatit.

2

Një tuf'trëndelinash i mblodha nér fusha,  
Ju kini mall, zëmra pér 'to seç u digjet,  
Me uj' Këndrevice pagurin ua mbusha  
Të shuani prap etjen, se buza u piqet...

3

Para lapidarit, i heshtur qëndroj  
S'ju kam par' asnjerin, nuk më njeh askush.  
Të mundja, të gjithve me zjarr t'ju qafoj  
Dhe këngës së secilit, t'ja mirrja mes jush! .

## J E T A

Jetë  
ësht' beteja,  
që jo një herë  
do krah' herkularë dhe forcën e Anteut:  
ajo ësht' luftë pambarim  
në fushë të blert' dhe dete me stuhi.

I lumtur ësht' ai  
që n'akordet e jetës,  
për lavdin' e Atdheut,  
di të thurë  
(pa bërë zhurmë!)  
më të madhërishmen  
melodi!

## D R U A J T J E

Ndenja shpesh gjer vonë nëpër netë,  
Vargje thura shum' për një syzezë...  
Nëpër rima derdha mall e derte,  
Ndonjëherë prita dhe mëngjerezë.

Dashurinë e çfaqa shpesh me bujë,  
Për çdo gjë që njerézore quhet;  
Po gjithmonë ja fsheha veç dikujt  
Më të zjarrtën dashuri që s'thuhet.

...Pas çdo udhëtimi, kam menduar  
Sa i shënjtë ësht' për ne ky dhé!  
Kësaj toke, pakë i kam shkruar  
... Druhem, se e çmoj fjalën **ATDHE**.

## **PO FRYN ERA, ER' E MALIT...**

— Balladë —

1

Po fryn era, er' e malit, vjen me tërsëllima;  
Tej, një lis me shtatë dega, dogji vetëtima.

...Rënkon trimi dhe zvarriset, tutje tunden  
malet;  
Më në fund, në vala gjaku, pran' një guri  
ndalet.

Mot' i egër po derdh lotë, era ulurin;  
...Rënkon prap, e prap zvarriset, trimi përmbi  
trim.

2

Po fryn era, er' e malit, vjen me tërsëllima;  
Derdh natyra lotët — lumë, çirret suferina.

...Prap i mbylli trimi sytë, u mbështet mbi gur.  
Gjak të ri merr çet' e tija, gjaku s'shteron  
kurre.

Bie një e ngrihen dhjetë, se heronjt' nuk  
vdesin;  
..Shkrihet plumbi brënda gjoksit, sytë ha-  
pen... presin!

### 3

Po fryn era, er' e malit; udhëa ësht' e largë...  
Ja, kolonat partizane ngjiten malit varg.

O kjo erë, er 'e malit! çon një fjalë trimi:  
Për syzezën amanet, rrahuq nga thëllimi...

S'rënkon më. Edhe rrufeja qiejt përvëloj!  
Ja, ngadal'... si pritet gjaku, mbyllen sy e  
gojë...

### 4

Po fryn era, erë fushe, sjell me ligjërimin  
Atë zë të ëmbël vashe, që do zgjojë trimin...

Preu flokët labëresha, u nis për në mal:  
— «Nëmni pushkën dhe gjerdanin, hakën do  
t'ja marr!»

## BUSTI I NAIMIT

Vendosur bustin sipër një karroce,  
Për në një fshat malor po e dërgojnë.  
Pran' bronxit — një jastëk, një trastë jonxhe;  
Kuriozët ndalin hapin dhe vështrojnë.

E nisi udhën tutje xha Zeneli,  
Po ndali tek një çezm' pér t'u freskuar;  
Dhe ndërsa uj'po pinte lelepreri,  
I zoti shihte bustin i menduar.

Cibukun nxjerr dhe afér tij qëndron,  
Diç pëshpërit, në sy e vështron drejt,  
I duket se Naimi e dëgjon:  
— Po ty, im bir, përmëndësh të di krejt!

... Arritën në mes fshatit. Njerëzia  
Po mblidhen rrotull bustit e këndoja;  
Nga kodrat ku kullosin bagëtija  
Xhuraja e zilet sa ëmbël jehojnë!

## K R E N A R I

E desha Tiranën e bukur  
Me operat, rrugët e parqet;  
E desha mikeshën q'u ndamë  
Dikur, pa ia puthur as faqet.

I desha un' netët me hënë,  
Shëtitjet e së dielës n'Tiranë...  
Mbrëmjet studenteske i desha,  
Se gjurma në zemër më lënë...

...Kaloj tani ditët — këtu  
Në baltë, në shi edhe erë;  
Dhe opera, parqe e mbrëmje  
Më shkrihen në fjalën «minierë».

Atë që dikur s'e pranova  
Arrita këtu ta kuptoj:  
— Nga pun' e vështirë, vet'jeta  
Gjithnjë krenarin' do burojë!

## BALLADE PËR ZAJET E LUMIT

1

Ish natë dhe shi i rrëmbyer,  
përleshej mal i me retë.

... Midis dy brinjëve  
të gjoksit herkular,  
hëpej një plagë e thellë që kullante.

2

Një luzmë zajesh shpërthenin nga plaga  
dhe nisnin revanin,

si një kopë delesh që vërsulet greminës,  
e ndjekur nga ujqit e harbuar...

Ishin zaje që mirrin me vehte,  
një lamtumirë  
të dhimbëshme,  
të gjyntuar...

... Malit iuk hapën brinjët,  
rëndë e goditën,  
e gërryen kudo me miliarda cfurngji

po nuk ja cenuan dot pavdekësinë  
dhe as hijerëndën  
burrëri.

3

Mëngjes.

Rreze ultraviolet,  
...kurohen plagët e Viganit.

Po dremit, i lodhur.

Kështu,

miliona herë i ka ndodhur,

po prapë

jeta nuk ka fund:

Retë vinë e shkojnë,

po Titani tokësor mbetet i përjetshëm,

i urtë

sa edhe i tmershëm.

4

...Buzë lumit,

memecër zajesh të bardhë.

Zaje që mbartin një dhimbje të thellë

dhe dashuri të madhe e të heshtur

bashk' me të,

përzier me mallin përvëlonjës

për ato maja ku s'do kthehen më!

1949

38690

17

## TE PËRSHËNDES, O MAJ!

### 1.

Epokë  
e mbarsur me revolucionë.  
Rend në gjoks të saj  
i pashuari Diell' i çlirimit  
i zjarrtë e i ndritur,  
i palodhuri,  
meridianeve të rruzullimit  
përmes suferinash.

... Ai s'kthehet prapa,  
rend,  
përpara gjithmonë,  
i përshtendetur,  
mes moteve të turbullta,  
nga të panumurta  
alarme vetëtimash.

### 2.

Revizionizmi  
nuk do mundë ta përcjellë t'infektuar  
këtë shekull revolucionesh e shtërgatash.  
që dritatë të reja po i hap njerëzimit!

Le tē bredhin akoma  
minjtē e bodrumeve,  
q'u zgjuan nga letargjia e nisën revanin  
nëpér llagëmet e Kauckit e Bernshtajnit...

Këmbana e revolucioneve  
po u këndon salanë,  
e tundur  
nga vigania dorë proletare!

### 3.

Manjatët luftënxitës,  
dridhen në panik,  
sot  
kur, si një hymn i Universit,  
nga miliona gjokse proletare,  
kushtrimi titanik  
çdo skaj tē globit e pushton;  
— Bot'e re do jet' internacionale!  
bot'e kapitalit  
do shëmbet përgjithmonë!

### 4.

Socializmi po marshon  
përpara  
dhe ngjyrën globit  
ja ndryshon në harta...  
Rivolucionet  
lindën kombe tē lirë,  
revolucionet  
mëkojnë gjenerata!

## 5.

Prej vendit, ku nér qiej  
ka veç kaltërsi;  
nga atdheu im  
komunistja,

e paepura Shqipëri,  
të përshëndes, o botë e madhe  
proletare!

Në këtë Maj të bukur,  
me këng' e fishekzare,  
ndërtuesit e gjigandit në Fier,  
Laç, Bradashesh,  
madhëruesit e rinj,  
të lavdisë së vendit tim,  
ngrenë duart para teje,  
dhe të përshëndesin  
me nderim!

## 6.

Nga vendi ynë i blertë,  
të përshëndes, o Maj, me krenarinë  
e shqipeve majë maleve,  
që, mes furtunash,  
syrin-pishë

e zemrën të patrandur  
kanë gjithmonë;  
dhe hymn u ngrejnë  
Agimeve të flakta,  
sinjal revolucionesh,

të epokës sonë!

## LERA

### 1.

Majë malit, s'dihet se qëkur,  
Yjet lajnë sytë në një lerë,  
Me uj' borë që nuk shteron kurë,  
Etjen shuajnë në haúz të thellë...

2.  
Në pasqyr' të virgjër krihet hëna,  
Dergjen derte yjesh në një lerë;  
Notojn' ishuj resh, lodhur e të ngrëna.  
Ujë merr baresha, rët' i shkel.

Thur mëngjesi èndërat e ditës,  
Thyhen frëze ari në një lerë.  
Clodhet kal' i qyqes, vënd mikpritës!  
Kujton cula gërshtin e prerë!

## VEGJELIA IME

— Nënës time —

1

E djegin lebrit kur e do zakoni,  
Po... ish një jetë qëni! — ajo jetë...  
Kur linda unë, petullat kërcitën  
Dhe pul' e bardh' u ther n'atë davet...

Të tretën dit (siç thonë) kur vun' emrin,  
S'kish mbetur thua gjalpi në qináre;  
Ndaj bëri mëm' e shkretë një kulaç  
Edhe pér petulla... s'u fol më fare.

Djepi i vëllait, ashkla ishte bërë,  
Me 'to u ngrohën kur frynte suferina.  
...Një magje druri gjetën, pak të madhe;  
Ish e arnuar rrëth me llamarina.

Atje, me shpargër mëma shpejt më lidhi,  
Kur ca bujashka nën kurriz më shtruani;  
Jastëk më vunë pastaj një llabane  
Dhe me një zhakë trupin ma mbuluan.

Kur kthehej malit mëma, për çdo mbrëmje  
 Më gjente mua shëmbur lot e vaj,  
 Shkarkonte shpejt barrën me përralle,  
 Më mirr në gji e gji më jip pastaj...

Më zinte gjum' i ngrohet n'atë afsh,  
 Që në bot' vetëm nënët na e kanë!  
 Eh, sa këng' tëmbla aher' më këndonte,  
 Dhe magjen... djepin tim, afronte pranë....

Kur mbusha të shtat' vjetët, më tregonte  
 (Eh! sa plagë i la lufta asaj!)  
 Se si jetonim brënda në një shpellë,  
 ...Dhe sytë shpejt i erreshin në vaj...

— O bir! ne qullin hanim dhe pa krypë,  
 Kur barku mbetej bosh, brezin shtërgonim.  
 Qem' futur shpellave dhe prisnim ditën,  
 Kur hësmin trimat tanë do ta shpëtun.

Sa her' iu falëm Zotit, nëpër netë,  
 Kur binin rrotull gjylet vetëtima;  
 Ish strofk' e ujqve shpella ku ne rrinim,  
 ...Ata na vinin rrëth me ulurima.

Dhe ty, o bir, mbi dy litare varur  
 Ta kisha lidhur trupin n'atë shpellë;  
 E dogji lufta «magjen» tënde... bir,  
 Dhe... nina-nana s'kishte më aherë!

Gjëmimet, edhe shpellën na e tundnin;  
Sa her' pér juve gjaku na ka ngrirë!  
Po ikën, biri im, vanë ato kohë,  
Ti mos m'u tremb, ne jemi sot të lirë!

4

— ... «Tri ishin shterpa, katër qen' pëllà,  
Djal' i argatit qe dikur me 'to...»

— ... «Një stetoskop në xhep, në tjetrin  
vargje...»  
Ka ligje jeta jonë,  
apo jo?!

## MENDIME PRANË STANIT...

Udhëton kjo natë vere pranë stanit tim  
dhe unë,  
çlodh e ngatërroj trutë e përgjumur  
me numurime yjesh të panumurt.

I përzura mendimet,  
për t'i marrë akoma kësaj nate labe  
edhe një sy gjumë gjer n'agim,  
nën këtë napë të ndritur e të pafund yjesh,  
pran' stanit tim,  
këtu... ku bie erë cëfakash e tërfili.

...Natë labe,  
me një culë të vonuar, që ligjëron me derte  
ledheve ku bariu gjumin vret me këngë,  
tek kullot kopenë,  
ndërsa mendja i vete te gërshet' i bukur,  
atje... n'ato lugje ku vajza ka noménë.

... Natë labe,  
me mendime bujqërish për punët e nesërme,  
me biseda të çudiçme turtujsh ndër korije,  
me qetësi krojesh

dhe me shqetësimin tim për aftësinë e vjershave

të të shtojnë ty,  
qoft' dhe një grimcë bukurie!

...Natë labe,  
qëndisur me yje shaminë e kokës  
dhe mbushur prehërin me qingja të bardhë...

O netët labe,  
që përjetësisht  
u dogjët nér agimet e trëndafilta!

O stane,  
ju, o stane lesbërish!  
që s'ju këmbej  
as me vilat buzë deteve të kaltër...

Tek ju,  
tek ju e gjeta prehjen, frysmezimin,  
dhe vdekjen  
pranë jush e lakmoj,  
...atje mbi atë ledhin,  
ku ësht' një gur i bardhë  
dhe lule mali mbijnë çfardolloj...

Po sonte  
unë mendoj për jetën,  
edhe më ngjan  
se yjet që këputen qiejve pa anë,  
të ndezur jan' e të zhuritur  
për ujë nga gurrat e Labërisë sonë...  
...Ndaj ulen ata posht'  
dhe, pasi shuajn' etjen,  
digjen

mbi kokat e trimave që prehen përgjith-  
monë  
në gjin' e kësaj balte të ëmbël e të shënjtë!

... I përzura mendimet pa numur,  
që më ngatërrojnë trutë e përgjumur.  
Vetëm një mendim nuk e përzura kurrë,  
se vetëm ai  
m'i mbylli ngadalëz qepallat e lodhura,  
qysh nga çasti fatlum,  
kur gjyshes, që po ndillte pulat,  
të parën bejte i këndova unë..

Ai mendimi i kthjellët  
u madhërua më pas mbi vitet e blerta,  
duke zbehur pa kuptuar  
ëndrat e mijë pasionet, dashuritë.

...Ah! sikur ta dija:  
a do të muñdem një ditë,  
krenarinë që linda në këtë truall  
në vargjet e mi  
ta skalit?

## FRYMEZIMI IM

U deha që i vogël me aromat  
Që kundërmon behareve çairi,  
E gjumi më ka zënë në mesditë,  
ku bie erë dafina edhe bliri.

Atje kam ëndëruar shumë vite  
Ta thithja me gjith' shpirtin kaltërsinë.  
Kërkova shpesh tërfil me katër fletë,  
Edhe shelegët ballin ma lëpinë...

Tek një lofatë e fsheha Abetaren,  
Ortakët për atë kishin zili;  
Akoma edhe sot, një flet' të saj  
E ruaj në sënduq si për çudi.

As bregun me dëllënja s'e harroj,  
Ku culës ja kam dredhur aqë netë...  
Nga degët e gorricës, buzë lëmit,  
Kam ruajtur baldosën unë vetë.

Lajthizave kam ecur për çdo mbrëmje  
S'i kam harruar curr' netët mavë...  
Atje ku rrjedh një krua i vetmuar,  
Kam mall për t'u kthyer dhe tanë...

## DASHURIA IME

Sonte unë jam i dashuruar,  
m'i lumturi në botë  
sonte jam unë.

E di,  
janë aq shumë  
ata që dashurohen  
në këto çaste  
kur e pushtetëshmjë Dashuri  
bredh mbi qetësinë e trazuar të Globit.

Po lumturia ime,  
në këtë cep të Kuq të botës,  
ësht' diçka më tepër,  
gjersa ajo mbart  
jo mallin e ri të një dashurie të vjetër,  
po copëza gjëzimi pér lumturinë e milionave,  
edhe urimet që dalin nga zemra  
pér shqetësimin  
e atyreve që sonte  
mbetën pa dashuruar.

## PËRTËRITJA E PLAKUT

— Poemth —

### 1

Në maj' të malit, larg në Këndrevicë,  
Tok me kopenë rron Rexhep Hamiti,  
Atje ku bie erë trëndelinë  
Kaloi gjashtëdhjetë gjysma viti.

Një ditë prilli, papritur... në gazetë  
Me zë të lart' një shok diç i lexon...  
«Më paska nxjerrë Qeveria vetë!»  
Dhe zemra e Rexhepit shpejt gufon.

Po, ku ta dijë ai, se gazetari  
Që erdh para ca kohësh, një mëngjes.  
Nuk deshi t'i tregonte c'kish ndërmënd.  
Dhe n'aparat e mori pran' kopesë...

Iu bë zemra mal Rexhep Hamitit,  
Dhe jetën nëpër mjegull e kujtoi...  
I vuri dhënt' përpara atë ditë  
Edhe i vetëm gjithë ditën këndoi...

Njësitet partizan i printe udhën,  
Kur para syve vërvhëllente plumbi.  
Dhe në betej' nga plasja e një bombe  
Një sy edhe një krah përjet' i humbi.

— Po shkoni ju përpara, djemt' e mi!  
Kollaj nuk epet ky Rexhep Hamiti.  
Dhe me një vig e kthyen në nomé  
Dy shok' që u caktuan nga njësiti...

Pa dashur, seç i rrodh' dy pikat loti,  
Kur njëzet vjet të shkuar i kujtoi.  
... E ndoli qenin, dhënt' i vu përpara  
Dhe dielli në det u ul e perëndoi.

Kur në nomé arriti, atë shokun  
E thirri pran', që hallin t'ja dëftejë;  
— T'i shkruash sekretarin të partisë,  
Rexhep Hamiti në Tiran' do vejë.

Ti thuash se, u bënë kaqë vjetë  
Që majë Këndrevicës rrë e i këndon  
Enverit që e kemi trim me fletë;  
Po këtë radh'... ta shohë dësheron.

Atje, siç the, do bëhet fest' e madhe,  
Një Majin po e presin me gëzim.  
Pa, në mos gjeça vënd përball'atij,  
Un' me rinin' do shkoj parakalim.

Të falura, shëndet çomi Komitetit  
Dhe sekretarin fort e përqafoj;  
Një ftesë që të mbajë emrin tim  
I lutem, sa më shpejt të ma dërgojë.

2

Ja, erdh Një Maj i ndritur dhe Tirana  
M'e bukur se çdo vit po e kremon;  
Karshi tribunës, ku vështron një popull,  
Rexhep Hamiti — djalë po qëndron.

Dhe rrreth e rrrotull gjith' duartrokasin  
E bulevardi brohorimë ushton.  
Po vetëm një qëndron pak i kërrusur  
Dhe nuk lëviz, nuk flet po vëç vështron...

— Bir, ai është q'i qeshur tund kapelën?  
— Ai, o xhaxho është Enveri yetë!  
... Një popull brohoret sa tundet dhei  
Dhe Prijësi me gjith' shokë e përshtendet...

Kur... ja, mbaroi krejt parakalimi,  
Po zor e ka një plak ta lere vendin...  
Pa mblidhen rrötull tij nga njëzet veta;  
Rexhep Hamiti flet e mban kuvëndin:

— M'u kthyen sot një sy edhe një dorë,  
Që luft' e rrept' papritur m'i rrëmbeu;  
Besoni... vij nga malet plot me bore,  
Dhe prap atje do shkoj të më tres' dhei...

### 3

Atje në mal të lart' të Këndrevicës,  
Ku vetëm trëndelina bie erë,  
Verojnë për çdo vit dhënt' e Nivicës  
Dhe ujë bore pijnë në një lerë.

Aty jeton gjithmon' Rexhep Hamiti,  
Gëzim' i madh e bëri prap të ri...  
Ai shum këngë Partisë vet' ja ngriti  
Dhe... ball' tribunës vëndi rezervuar rri.

## L A M T U M I R E

Ti, Tefta...

kaq shpejt u shove nga kujtesa ime!

S'ka gjë,

kështu e kanë dashuritë e vogla,

që udhën u hapin dashurive të furishme

S'qe ftohur mirë kamina,

kur mörëm nga një copëz gëlqere

dhe, në tabelën e jetës sonë

ne hoqëm

secili nga një vijë paralele...

Dhe morëm udhë të ndryshme.

E natyrshme:

koha që kalon

ësht' fshirësja e butë që korigjon gabimet  
në tabelën e çudiçme të jetës sonë,

Dhe ndodh

t'i fali tekat e një vajze të llastuar,

edhe të njoë mëshirë,

Po ajo ikën e s'kthehet,

ikën... Lamtumirë!

## PËR JETËN TONE

1

Ndaj dashurisë  
jam delikat,  
dhe (pse ta fsheh)  
më rrëmbejnë yjet, hëna, qiparizat  
e dielli kur mbi detin perëndon...  
Shpesh vargu im  
bie erë romantizmi,  
edhe për vajzat  
... ca si tèpër ligjëron.

2

I tillë jam dhe s'jam pishmënd.  
Po unë  
nuk mund të rri në vënd  
sot,  
kur, jo këndezi,  
por siren' e punës  
atdheun tim për çdo mëngjes e zgjon.

Nuk mund të rri në bisht të një armate,  
që malet e padiges ngriti përmbi supe  
dhe në greminë i hodhi përgjithmonë!

Sot,  
 s'ka kohë tek ne për psherëtima  
 dhe dashuri e madhe  
 nuk mund të pijë ujë ndër deklarata,  
 këtu, tek ne,  
 ku sinfoninë e jetës thur çekani,  
 pistoleta  
 dhe ar të zi nga galeria  
 mbledh e shtyn lopata.

Të zjarrrta këngët duhen për njeriun,  
 për jetën tonë  
 duhet tjetër gamë,  
 këtu,  
 ku ndodh që, pushk' e mbushur plot,  
 një dorë gjizë e një cop' bukë të misërt  
 akoma t'i mbajë pranë...

Kur, kryelarta Shqipëri punëtore  
 i shtyn akoma me një sup vagonat,  
 edhe me mëngë.  
 fshin njollat e qymyrit mbi ballin e metaltë.  
 kënga e poetit,  
 këtë të madhërishëm timbër  
 ta ngrejë sa më jart,  
 që si një Hymn i brezave të mbesë!

Sot,  
kur minatorët nga thellësi e malit  
nxjerrin  
madhështinë e s'ardhmes  
dhe tonelatat e mineralit,  
që do ushqejë oxhaqet viganë të Komu-  
nizmit.

6

Para gjumit,  
i ligjëroj aq bukur vajzës që më josh,  
pastaj  
i them ta shtrijë njerën dorë të saj  
në qafën time,  
se pushkën kam nën kokë;  
...«akoma më këndeja... — i them;  
e puth,  
e bie në èndërimë...

7

Janë fort dehëse  
ëndrat dashurore,  
orëve të vona,  
edhe kur kokën kë mbështetur përmbi pushkë...  
se sot,  
që të mos zbehen kurrë buzqeshjet tona,  
që dhe poeti të jetë një luftëtar,  
arma duhet mbajtur pranë  
dhe sytë t'i bëjë katër  
çdo shqiptar.

Atdhe,  
unë kurrë s'do rend në «vënd-strehim»,  
po qe se ti e jep alarmin,  
por pushkën do rrëmbej  
dhe në llogore,  
ku gjokset do radhiten mal-mburojë,  
do ta ndal vrapin.  
Atdhé!

## PËRME AJTJA

	Faqe
Atdhe	3
Ylli i mëngjezit	4
Në udhën e vjetëve	6
Dëshmorëve	8
Mëngjez i kuq	9
Jeta	10
Druajtje	11
Po fryn era, Er' e malit	12
Busti i Naimit	14
Krenari	15
Balladë për zajet e lumit	16
Të përshëndes o maj	18
Lera	21
Vegjelia ime	22
Mendime pranë stani	25
Frymëzimi im	28
Dashuria ime	29
Përtëritja e plakut — poëmth	30
Lamtumirë	33
Për jetën tonë	34